

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 1.08.2024*

**1.08.2024
Ora 12:14**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancë kemi diskutimin për caktimin e një qendre votimi në ambient privat në KZAZ-në nr. 88, Himarë. Shumë shkurt Erjon!

Z. E. Meta: Kryetari në detyrë i Bashkisë Himarë në datën 16.07.2024, ka sjellë informacion lidhur me caktimin e qendrave të votimit në Bashkinë Himarë për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024. Ne këtë shkresë është përcaktuar ndër të tjera se vendndodhja e qendrës së votimit nr. 4589/00 është me vendndodhje në ambientin publik Rruga “Xhorxh Tened”, nr. 4, Shkolla “Spile” ose ndryshe shkolla “Nikolla Pano Meniko”. KZAZ nr. 88 nëpërmjet kryetarit të saj ka përcjellë në KQZ shqetësimin se ambienti që propozon pushteti vendor është jashtë hartës së zonës së qendrës së votimit nr. 4589/00 dhe e bën votimin dhe pjesëmarrjen të pa aksesueshme duke marrë parasysh dhe moshën e madhe të shumicës së votuesve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 1.08.2024*

Nga ana tjetër KZAZ ka pohuar dhe ka paraqitur një deklaratë nga pronari i një ambienti privat që ndodhet brenda qendrës së zonës së votimit. Në lidhje me këto propozime nga ana e KZAZ nr. 88, KQZ ka kërkuar informacion nga Bashkia Himarë, e cila ka informuar se vendndodhja e re nga vendndodhja e mëparshme dhe nga zonat ku banojnë zgjedhësit e kësaj QV-je është në një distance prej 2500 metra. Bashkia pohon se vendndodhja e re e QV-së nuk është brenda zonës së saj të qendrës së votimit, dhe ka ndryshuar vendodhjen për shkak se nuk ka ambient publik dhe as privat që mund të jepet me qera. Nisur sa më sipër, KQZ ka kryer verifikimin në terren në lidhje me këto propozime ku ka konstatuar se, ambienti i propozuar nga KZAZ nr. 88 është brenda zonës së QV e cila ka shërbyer për disa procese zgjedhore pararendëse si QV. Gjithashtu duke marrë parasysh dhe periudhën kur po mbahen zgjedhjet e pjesshme për kryetar Bashkie Himarë, ky ambient vjen në favor dhe është më pranë zgjedhësve. KQZ ka administruar edhe dakordësinë e pronarit të objektit zotit Odhise Milo, i cili është i gatshëm për të dhënë objektin për qendër votimi. Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, rezulton se Bashkia Himarë nuk është në kushtet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës së votimit sipas rregullit të përcaktuar në nenin 62, pika 4 të Kodit Zgjedhor, për shkak se mungojnë arsyet objektive. Neni 62, pika 4 e Kodit Zgjedhor, dikton se vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive, apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Referuar dokumentacionit të propozuar nga KZAZ dhe të administruar nga KQZ rezulton, se në zonën e qendrës së votimit nr. 4589/00 ka propozime për ambiente të përshtatshme në ambiente private që mund të shërbejnë si qendër votimi. Referuar inspektimit në terren rezulton se vendndodhja e qendrës së re të votimit është caktuar në një ambient publik me një distancë rreth 3 km dhe një kohëzgjatje mesatare të udhëtimit të banorëve 25/30 minuta vajtje dhe po kaq në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 1.08.2024*

kthim. Referuar listës së zgjedhësve, rezulton se mosha mesatare e zgjedhësve të kësaj qendre votimit është 50 vjeç. Nga 691 zgjedhës rreth 312 zgjedhës janë të grupmohës mbi 50 vjeç. Periudhat zgjedhore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor janë ndërmjet datave 15 Prill – 15 Maj apo 15 Tetor – 15 Nëntor. Duke mbajtur parasysh që zgjedhjet nuk mbahen në asnjë prej këtyre periudhave zgjedhore, por do të zhvillohen, në sezon veror, me temperatura të larta dhe territorin e thyer, distanca e largët nga banesat te zona e tyre e qendrës së votimit, vështirëson aksesin dhe mundësinë e zgjedhësve të kësaj qendre votimi për të ushtruar të drejtën e tyre të votës. Referuar nenit 62 pika 11, KQZ ndërhyt kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive politike në KQZ, për të zbatuar kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre. Në kushtet kur propozimi përmbush kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator, rekomandohet që vendndodhja e qendrës së votimit të ndryshojë nga ambienti publik që është parashikuar të shkojë në ambientin privat në Rrugën Milto Kallushi, me pronar zotin Odhise Milo. Projektakti ju është dërguar partive politike për mendim dhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste ka shprehur mosdakordësinë dhe ka kërkuar kohë. Ndërsa përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka shprehur dakordësinë me projektaktin.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Do ta shtyjmë, do t'i japim kohë atyre që deri në orën 18:00 të ditës së sotme, të plotësojnë çfarë do të duhet në pikëpamje të kushteve dhe infrastrukturës të kësaj qendre votimi private. Komunikoni me KZAZ-në, meqenëse në shumicë kanë kërkuar që kjo qendër votimi të vendoset te ky ambient privat, për shkak se është më e përshtatshme për interesin e votuesve, se sa ajo tjetra që megjithëse është publike ka një largësi prej 2.5 km. Në këtë kohë krijon vështirësi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 1.08.2024*

sidomos për një kategori të caktuar votuesish. Sot deri në orën 18:00 duhet të marrin masat për ta përshtatur ashtu siç duhet një qendër votimi. Mirë, faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 18:04

Pjesëmarrja:

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Znj. M. Koja, z. E. Meta.**

Z. I. Celibashi: Rifillojmë seancën në lidhje me rivlerësimin e kërkesës për caktimin e qendrës së votimit në ambient privat, për zgjedhjet për Bashkinë e Himarës. Po Erjon!

Z. E. Meta: Në vijim të relacionit të paradites dhe detyrave të ngarkuara nga ana juaj, nga KZAZ-ja është raportuar si dhe pas inspektimit që ka bërë KQZ-ja në terren, rezulton që ambienti tashmë është funksional. Ky ambient i ka të gjitha paisjet dhe elementët për të ushtruar aktivitetin e qendrës së votimit në ditën e zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: E keni marrë të gjithë informacionin dhe janë në rregull, me tavolina, karrige, paisjet..?

Z. E. Meta: Po, po dhe me freskuese...

Z. I. Celibashi: Dakord! E miratojmë vendosjen e qendrës së votimit 4589/00 në ambientin privat të propozuar. Tjetër çështje nuk kemi, e mbylлим seancën, faleminderit!

Vendimi nr. 159

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

